

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i përgjithshëm**, përmes gjyqëtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi , me procesmbajtësin Blerina Haziri, në lëndën penale kundër të pandehurit, A.R , për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 1 lidhur të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës, PP.nr. 1490/15/16, të dt. 18.09.2015 , të cilën e përfaqësonte Prokurorja e shtetit Bahtie Ademi , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më 03.08.2017 , shpalli publikisht, ndërsa më 07.08.2017, hartoi këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri A. Ri, nga baba R dhe nëna Z , e lindur H, i lindur më..., me vendbanim n fsh. Ll, K. e , Komuna e Gj, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar, i martuar, bab i dy fmijve, i gjendjes së mesme ekonomike ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës , më parë i pa dnuar , si dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër penale ndaj tij.

### Është fajtor

Sepse më 31.08.2015, rreth orës 13:15, minuta, në fshatin i pandehuri A. R, pa patent shofer, duke drejtuar automjetin e udhtarve të markës ..., me tabela të regjistrimit..., në rrugën lokale Pasjan-Llashticë, ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore të nenit 54.5 të Ligjit të Komunikacionit rrugor të Kosovës, ashtu që nuk ka përshtatë shpejtësinë e lëvizjes, kushteve të rrugës , për ta ndal automjetin para çdo pengese të paraqitur në rrugë dhe me të arritur në udhkryqin e rrugës së fshatit Pasjan- Llashticë, gjatë kthimit djathtas për në fshatin Llashticë, nga pakujedsia me pjesën e prparme të anës djathët të automjetit të tij, e godet në pjesën e përparme të anës së majtë automjetin e markës Opell Omega, me tabela ..të regjistrimit..., të ciln e drejtonte B. R, i cili në momentin kritik ishte i ndalur në rrugën që vinte nga fshati Llashticë dhe priste për tu kyqur në rrugën magjistrale Gjilan- Preshevë, me ç’rast nga aksidenti i shkaktuar përpos dëmeve materiale në të dy automjetet,

lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari B.R. nga fshati Ll , Komuna e Gj, i cili për shkak të natyrës së lëndimit, detyrohet të kërkoj ndihmë mjeksore në Emrgjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit.

Me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së.

Andaj , gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjore dhe neneve : 4 , 7, 41, 46, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-ës e në lidhje me nenin 365 të KPRK-ës, të pandehurit , i shqipton.

## **DËNIM ME GJOBË**

Ashtu që të pandehurit A.R, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 200.-€( dyqindë) Euro , të cilin gjobë gjobë, i pandehuri detyrohet që ta përmbushë në afatin prej 3 muajve nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mundet ta përmbush dënimin me gjobë në shumën si më lartë, atëherë gjykata të njëjtit dënimin me gjobë do t' ia zëvendësojë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgu me 20€ (njëzetë ) Euro gjobë.

Detyrohet i pandehuri që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale, gjegjësisht paushallin gjyqësor në shumë prej 30 € (tridhjet) dhe 20 € (njzet) Euro në emër të shpenzimeve për ekspertizn mjeko –ligjore të datës 15.09.2015, ref. 55/09-15, gjithsejt 50 Euro. Pagesa bëhet në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërsië së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm .

I dëmtuari B. Ri nga fsh. Ll Komuna e Gj, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest civil.

## **A r s y e t i m**

PTHDP në Gjilan ka paraqitur aktakuzën, PP.nr. 1490/15 të datës 18.09.2015, kundër të pandehurit kundër të pandehurit, A. R , për shkak të veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 1 lidhur të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilën , kanë prezentuar, Prokurori i shtetit Shefik Mehmeti dhe i pandehuri ...

Prokurorii i shtetit pas leximit aktakuzës në tërësi ka mbetur pranë pretendimeve të theksuara si në dispozitivin e së njëjtës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin t'a shpallë fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin meritor në pajtim me Kodin Penal.

I pandehuri A.R pasi që u njoftua me aktakuzën, përkatësisht veprën penale e cila i vëhet në barrë, i njëjti deklaroi se e pranojë fajësinë për veprën penale, konform dispozitivit të aktakuzës me numër dhe atë të shënuar si më lart.

Me që i pandehuri në shqyrtimin e sotëm fillestar , vullnetarisht e pranojë fajësinë, gjykata konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë konform nenit 248, par. 1 të KPPK-ës , andaj gjykata vazhdoj me fajalët përfundimatre të palëve.

Prokurori i Shtetit Shefik Mehmeti deklaroi : pasi që në shqyrtimin e sotëm në shqyrtimin e sotëm fillestar i pandehuri..., e pranoi fajësinë për kryerjen e veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 1 lidhur të KPRK-së ,dhe ate me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, pasi që nga ana e gjykatës u njoftua lidhur me pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, kështu që mbetem pranë aktit akuzues dhe propozimeve të cillat e njëjta i përmban dhe kërkoj nga gjykata që të pandehurin t'a shpallë fajtorë dhe t' ia shqiptoi sanksionin penal konform kodit penal. Me rastin e caktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit i prpozoi gjykatës që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, pastaj shkallën e përgjegjësisë penale, rrezikshmërin shoqerore te veprës dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

I pandehuri..., deklaroi: e pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën më vë në barrë aktakuza , pendohem për veprn e kryer ,i kërkojë falje të dëmtuarit , duke premtuar gjykatës se në të ardhmen do të kemi kujdes gjatë drejtimit të automjetit, kështu qëj kërkojë nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptojë një dënim me të butë.

Andaj gjykata, konstatoi se te i pandehuri ....qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 1 lidhur të KPRK-së, për çka është edhe penalisht përgjegjës, prandj të njejtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes se dënimit me gjobë ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit , ku si rrethana lehtësuese ka marrë për bazë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarit. Ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Sipas bindjes së kësaj gjykate dënimi me gjobë, sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit , me bindje se edhe me këtë dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës, po ashtu gjykata vleron se ky dënim do të ketë efektin prevntiv për vet të pandehurin si dhe personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 par. 1 e lidhur me nenin 450 par. 1 nëpar. 2.6 të KPRK-ës .

I dëmtuari..., konform nenit 463 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë , është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i pergjithshëm**

**P.nr.971/15,më 07.08.2017**

**Procesmbajtësja**

Blerina Haziri

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

Islam Thaçi, d.v.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi , mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamenti i pergjithshem në afat prej pesmbëdhjet (15) diteve, nga data e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje te mjaftueshme , dorëzohet përmes kësaj gjykate.